



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:010330

Datë: 14.02.2024

Numri i dokumentit: 05325262

P.2021:013352

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, në çështjen penale ndaj të pandehurit B.D, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosja nga neni nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.68/21 e datës 22.01.2021, më datë 14.02.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimi 03/24 e datës 30.01.2024 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimi e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit B.D dhe të palës së dëmtuar A.T.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.68/21 e datës 22.01.2021 ndaj të pandehurit B.D për shkak të veprës penale Kanosja nga neni nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së, pasi që lënda është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimi.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.68/21 e datës 22.01.2021 ndaj të pandehurit B.D për shkak të veprës penale Kanosja nga neni nga neni 181 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjti t'i shpall fajtor dhe të e dënoj sipas ligjit.

Gjykata me kërkesën dhe pëlqimin e palëve e referoi lenden në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimit 03/24 e datës 30.01.2024

Lidhur me shpenzimet procedurale është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ  
DEGA KAÇANIK  
P.2021:013352 të datës 14.02.2024

Gjyqtari  
Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.